

## Dhoma e Biznesit të Diasporës

Rr. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 13/3, Tiranë

K.P. 1001, Tiranë-Shqipëri

[www.adbc.al](http://www.adbc.al)

e-mail: [info@adbc.al](mailto:info@adbc.al)

## Shoqata Italiane e Kultivuesve

Associazione Italiana Coltivatori (AIC)

Via Torino 95, 00187 Roma-Italia

<https://www.aicznazionale.com/>

Email: [info@aicnazionale.com](mailto:info@aicnazionale.com)

Mundësuar nga :



*Informacioni dhe pikëpamjet e shprehura në këtë broshurë nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e IOM Albania.*



Broshura nr. 5, shtator 2021

# Angazhimi i Diasporës në transferimin e njohurive bujqësore në Shqipëri

## Përfshirja sociale e zonave rurale



### **Informacion i përgjithshëm rreth koncepteve të përfshirjes sociale**

Përfshirja sociale është përcaktuar si procesi i përmirësimit të tërësisë së formave të pjesëmarrjes në shoqëri, në veçanti për individë apo grupe shoqërore të gjendur në mjedise dhe situata me disavantazhe krahasuar me pjesën tjetër të shoqërisë, nëpërmjet zgjerimit të mundësive, krijimit të aksesit në burime, forcimit të integritetit për tu shprehur dhe natyralizuar të drejtat njerëzore.

Përfshirja sociale synon që të gjithë individët të jenë të mundur të sigurojnë një punë, të përdorin shërbimet, të komunikojnë dhe ndërveprojnë me familjarët, grupin shoqëror, ekipet e punës, të shprehen dhe realizojnë synimet personale dhe ndërveprojnë në komunitet, të kenë mbështetje në kapërcimin e krizave personale dhe zëri i tyre të dëgjohet.

Koncepti i përfshirjes sociale u themelua në vitin 1957 nga antropologu dhe sociologu David Pocock i cili ka theksuar se përfshirja sociale sikurse edhe përjashtimi janë tipare të të gjitha hierarkive.

Përfshirja sociale është pesë dimensionale duke përfshirë planin shoqëror (shëndetësor dhe arsimor), politik, kulturor, ekonomik, mjedisor, dhe shtrihet në nivele të ndryshme të shoqërisë.

Modelet e përfshirjes sociale janë ndërtuar mbi bazën e formave të përjashtimeve sociale dhe janë pothuajse të njëjta në të gjitha vendet por në shkallë të ndryshme nga përmasat shtrirjes së problematikave të përjashtimit prej moshës, gjinisë, paaftësisë fizike dhe mendore, racës, etnisë, besimit fetar, statusi të emigrimit, statusit ekonomik-social, vendit të banimit, orientimit apo identitetit gjinor.

Praktikat me të mira të përfshirjes sociale përfaqësohen me pesë elemente bazë të cilat janë: marrëdhëniet, ndarja e eksperiencave, advokacia, sensi i identitetit dhe transparenca.

Për të përfituar efektet pozitive nga zbatimi i procesit të përfshirjes sociale në çdo dimension të saj, duhen mbajtur parasysh barrierat kryesore dhe duhen ndërtuar strategji apo plane për kapërcimin e tyre. Barrierat kryesore në përfshirjen sociale janë: mungesa e vetëdijes së nevojës për dije dhe aftësim profesional, paqartësi e rolit të stafëve mbështetëse dhe menaxhimit të shërbimeve, vështirësitë e terreneve ku janë lokalizuar banesat si dhe disa faktorë komunitarë si mungesa e komoditeteve dhe qëndrimet indiferente ndaj mungesës së tyre. Kuadri i përfshirjes sociale është i strukturuar në 4 parime bazë të cilat janë: njohja, respekti, projektimi i orientuar nga veçantia e qenies njerëzore dhe diversiteti.

## Informacion rreth koncepteve të përfshirjes sociale të zonave rurale

Zhvillimi rural është koncept gjithëpërfshirës dhe shumëdimensional. Përcaktimi i komponentëve bazë e bën më të qartë këtë koncept sikurse janë : zhvillimi i agrikulturës dhe aktiviteteve të lidhura me të; krijimi dhe zhvillimi i industrive të fshatit dhe verimit, mbështetja dhe zhvillimi i zejeve, shtrirja e vazhdueshme territoriale e infrastrukturës ekonomiko-sociale, shtrirja dhe mbulimi territorial i shërbimeve komunitare dhe lehtësirave të komunikimit dhe mbi të gjitha arsimimi dhe aftësimi profesional i burimeve njerëzore të zonave rurale.

### Pse zonat rurale janë të rëndësishme?

Zonat rurale janë burimi kryesor i pavarësisë ekonomike dhe mirëqeniejes së çdo vendi pasi zonat rurale ofrojnë të mirat materiale që vijnë nga burimet natyrore për të gjithë popullsinë si ushqimi, energjia, uji, bukuri natyrore, çlodhje, formojnë identitetin kombëtar duke përcaktuar cilësinë e jetesës.

Por aftësia e materializimit të burimeve natyrore në të mira materiale nuk mund të realizohet pa kapacitete njerëzore dhe zhvillimi i zonave rurale nga pikëpamja e infrastrukturës fizike nuk mund të shkëputet nga zhvillimi i burimeve njerëzore.

**Peter Ferdinand Drecker**, (19 nëntor 1909 – 11 nëntor 2005), konsulent austro-amerikan, mentor dhe autor i teorisë së menaxhimit, shkrimet e të cilit kontribuuan në themelet filozofike dhe praktike të korporatave moderne të biznesit ka theksuar: *“Burimet përfundimtare të zhvillimit ekonomik janë njerëzit. Është njeriu dhe jo kapitali i lëndëve të para që zhvillojnë një ekonomi”*.

Zhvillimi nuk mund të jete i përkohshëm apo segmentar. Është esenciale të kanalizohet vëmendja drejt një zhvillimi të qëndrueshëm të zonave rurale duke e konsideruar atë vital për ekonominë, shoqërinë, mjedisin natyror dhe garanci për të ardhmen.

Një nga programet orientuese të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian për përfshirjen sociale është ROMACTED i cili reflekton mbi përshtatjen e metodologjive dhe aktiviteteve të testuara, për çdo grup apo vendndodhje të nevojshme për përfshirje, në mënyrë që të arrihet një përshtatje me ciklin e politikave, dinamikën dhe realitetin e secilës njësi bashkiake, duke sjellë kështu një kontribut shtesë në politikat dhe praktikat ekzistuese për një efektivitet dhe funksionim gjithëpërfshirës.

## Informacion rreth dokumenteve institucionale të përfshirjes sociale:

**Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (2015 – 2020)** cilëson shërbimet e kujdesit shoqëror si pjesë përbërëse e funksionimit të pushtetit vendor. Gjithashtu, strategjia shpreh synimin e qeverisë për decentralizimin e plotë të shërbimeve të kujdesit shoqëror, përkundrejt mbështetjes teknike, institucionale dhe financiare nga burimet e buxhetit të shtetit.

**Dokumenti Politik i Përfshirjes Sociale (DPPS) 2016-2020, i miratuar me VKM Nr. 87, dt. 3.02.2016,** garanton një sistem bashkëkohor e të përgjegjshëm për vlerësimin e përfshirjes sociale në politika të ndryshme sektoriale si: mbrojtja sociale, punësimi dhe rritja e aftësive profesionale, shëndeti, arsimi, strehimi dhe sigurimi i nevojave bazë, por edhe në politikat e pjesëmarrjes sociale dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

### **Programi qeverisës 2021-2025**

Në program prezantohen edhe shumë elementë socialë, si rritja dhe zgjerimi i programit të ndihmës ekonomike, ndihma me 10 mijë lekë në muaj për shpenzimet e kopshteve dhe çerdheve për familjet me më pak të ardhura, investimi i 100 milionë eurove për ndërtimin e 2 mijë banesave sociale dhe subvencionimi i familjeve të reja me 1 milion lekë për të mundësuar pagesën fillestare dhe zbutur interesat në blerjen e një shtëpie. Sfidat e përhershme janë shëndetësia dhe arsimi. Krahas investimeve publike dhe shtimit të qendrave spitalore, premtohet rritje e aksesit në shëndetësi edhe për zonat më rurale dhe zgjerimi i paketave që ofrohen falas në shtet, si ajo okulare dhe orale për fëmijët.

Ndërsa objektivi për arsimin është ndërkombëtarizimi i universitetit, duke hapur filiale dhe programe studimi nga universitetet më të mira ndërkombëtare dhe ofrimi i disa programeve të studimit në gjuhën angleze në të gjitha universitetet shqiptare.

## **Përfshirja sociale e zonave rurale në spektrin e Dhomës së Biznesit të Diasporës**

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare (DHBD), u përkushtua në konceptimin, hartimin dhe zbatimin e projektit “Angazhimi i Diasporës në Transferimin e Njohurive Bujqësore në Shqipëri” me shtrirje në disa njësi bashkiake si Tiranë, Vlorë, Cërrik, Rrogozhinë, Kavajë me fokus transferimin e ekspertizës dhe praktikave me të mira italiane për trajnimin, aftësimin profesional dhe forcimin e kompetencës së fermerëve të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në bujqësi. Bujqësia përfaqëson sektorin ekonomik me kontributin më të lartë në PBB me 18.39 % (INSTAT, 2020) dhe angazhon 43.3 % të fuqisë punëtore të aftë për punë. DHBD vlerëson se çdo përmirësim i kapaciteteve njerëzore ka efekt të drejtpërdrejt në prodhim kryesisht, në rritje sasiore dhe cilësore duke ndikuar në rritjen e të ardhurave të sipërmarrjeve dhe të punësuarve. Grupi i përfshirë në këtë projekt ishin fermerët, punëtorët sezonale dhe sipërmarrës të industrisë bujqësore.

Projekti u finalizua me konferencën: “Përfshirja sociale në Zhvillimin Rural” që u organizua në partneritet me Shoqatën e Kultivuesve Italianë (AIC) dhe me mbështetjen e IOM Albania përfshirë në programin “Angazhimi i Diasporës Shqiptare në Zhvillimin Social dhe Ekonomik të Shqipërisë” financuar nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim.

Çdo iniciativë në tërheqjen e investimeve drejt përmirësimit dhe shtrirjes territoriale të infrastrukturave publike, sigurimit të aksesit të plotë në arsim dhe shëndetësi, trajnimet profesionale dhe trajnimet në fushën e marketingut bujqësor janë aktivitete të një rëndësie vendimtare për ruajtjen e territoreve rurale, zhvillimin e qëndrueshëm të tyre dhe për të shmangur braktisjen e zonave rurale, degradimin territorial me ndikim negativ në ndryshimet klimaterike. Mbrojtja e mjedisit është një nga benefitet shtesë në përfshirjen sociale të zonave rurale.

**Lidhja dhe efektet e përfshirjes sociale të zonave rurale në zhvillimin ekonomiko-social**

